



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P 809/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.12.2019, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** “Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Delta Doni” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-36194-09-17-2019, me objekt Loti 2 “*Blerje bulmet, qumësht, kos, djathë, gjizë*”, me fond limit 54.830.853 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.10.2019, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë.
- Ankimues:** “A G S” sh.p.k.  
Rruga “Beqir Luga”, Pallati nr.3, Shk. 1/1, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë  
Rruga “Barrikadave”, Tiranë
- Subjekte të interesuar:** “Delta Doni” sh.p.k.  
Fier, Kolonjë, Gorre
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 18.09.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-36194-09-17-2019, me objekt Loti 2 “Blerje bulmet, qumësht, kos, djathë, gjizë”, me fond limit 54.830.853 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.10.2019, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë.

II.2. Në datën 21.10.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 04.11.2018 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- |                          |                               |
|--------------------------|-------------------------------|
| 1. "MC Catering" sh.p.k. | 48.442.600 lekë, kualifikuar  |
| 2. "Delta Doni" sh.p.k.  | 52.352.000 lekë, skualifikuar |
| 3. "A G S" sh.p.k.       | 54.284.355 lekë, kualifikuar  |

II.4. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 11.11.2018 ka kryer ri-vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- |                          |                               |
|--------------------------|-------------------------------|
| 1. "MC Catering" sh.p.k. | 48.442.600 lekë, skualifikuar |
| 2. "Delta Doni" sh.p.k.  | 52.352.000 lekë, skualifikuar |
| 3. "A G S" sh.p.k.       | 54.284.355 lekë, kualifikuar  |

II.5. Gjithashtu, nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 12.11.2018 ka kryer përsëri ri-vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë:

- |                          |                               |
|--------------------------|-------------------------------|
| 1. "MC Catering" sh.p.k. | 48.442.600 lekë, skualifikuar |
| 2. "Delta Doni" sh.p.k.  | 52.352.000 lekë, kualifikuar  |
| 3. "A G S" sh.p.k.       | 54.284.355 lekë, kualifikuar  |

II.6. Në datën 15.11.2019, operatori ekonomik ankimues "A G S" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "Delta Doni" sh.p.k. sipas ri-vlerësimit të procedurës së mësipërme të prokurimit datë 12.11.2019. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon se:

[...]

*Pra, nga ana e KVO-se eshte marre vendimi per kualifikimin e operatorit ekonomik "DELTA DONI", pasi sipas shkreses nr. 56 Prot., date 11.11.2019 te AQCERT, administruar prane AK me Nr. 228 Prot., date 11.11.2019 operatori ploteson kriteret.*

*Shoqeria "AGS" Sh.p.k pretendon se (ri)-kualifikimi i operatorit ekonomik "DELTA DONI" eshte bere ne shkelje te hapur te Ligjit "Per Prokurimin Publik", te ndryshuar dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik", te ndryshuar, duke qene se kjo shoqeri jo vetem qe ka probleme lidhur me certifikimin e standarteve ISO, por ka edhe mjaftueshem mangesi te tjera duke mos plotesuar dokumentacionin e domosdoshem per kualifikim, te kerkuar ne DST, si me poshte vijon:*

Bazuar ne informacionin qe disponojme si dhe referuar kriterete te kerkuara ne DT, shoqeria jone ngre pretendimet si me poshte:

(1) Ne dokumentat e tenderit, Shtojca 9 "Kriteret e Pergjithshme tepranimit/kualifikimit", eshte kerkuar qe: ... Keto kriteret duhet te plotesohen me dorezimin e vetedeklarates me shkrim te subjektit, ne ditet e hapjes se ofertes, sipas Shtojces 8. Referuar permbajtjes se shtojces 8... "Operatori Ekonomik duhet te vetedeklaroje per ... Personi/at ne cilesine e anetarit te organit administrativ, drejtuesit ose mbikeqyresit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca perfaqesuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Referuar Ekstraktit te Regjistrimit Tregtar te Operatorit Ekonomik "DELTA DONI" rezulton qe kuotat e kapitalit te zoterohen nga 2 ortaket: 50 % nga Ortaku Ferdi Gjata (njekohesisht edhe Administrator) dhe 50 % nga Ortaku Edmond Gjata. Plotesimi i kesaj shtojce nuk eshte bere konform kerkesave te Ligjit per Prokurimin Publik, pasi nuk eshte plotesuar edhe per te dy Ortaket e Shoqerise:

(2) Ne dokumentat e tenderit, Shtojca 9 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, ne piken 1, shkronja (e) eshte kerkuar "Vertetimin qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik qe eshte i regjistruar ne Shqiperi".

Ne permbushje te kriterit te mesiperme OE, nuk ka dorezuar ne Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin (Vertetim debie) ne origjinal ose te noterizuar. Dokumenti i dorezuar nga ana e Operatorit Ekonomik eshte i pasakte, pasi ne DST-ne e publikuar nga Autoriteti Kontraktor, ne shtojcen 9 te saj eshte kerkuar qe: Te gjitha dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre. Rastet e mos-dorezimit te nje dokumenti, ose te dokumentave te rreme e te pasakta, konsiderohen si kushte per skualifikim.

Nga verifikimi prane OSHEE-se rezulton se operatori ekonomik eshte titullar dhe perdorues per disa kontrata ne qytetin e Beratit; per te cilin nuk ka dorezuar Vertetim te Shlyerjes se Taksave Vendore per vitet 2017, 2018, 2019 sipas pikes 2.1.1 te shtojces 9 te DST-se.

(3) Ne dokumentat e tenderit, Shtojca 9 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, ne piken 2.3.2, eshte kerkuar: Operatori ekonomik pjesmarres duhet te disponoje Certificate ISO 9001-2015, ISO 14001:2015, ISO 22000: 2018 ose ekuivalente me to, te vlefshme.

Nga verifikimi i KVO-se ne sistemin elektronik te AQSCert, ne momentin e vleresimit te ofertave u konstatua se standartet 9001 dhe 22000 jane te pezulluar dhe te pavlefshem dhe per kete arsye KVO-ia vendosi mete drejte skualifikimin e operatorit ekonomik.

Eshte e papranueshme qe KVO-ja te ndryshoje qendrimin dhe vendimin e saj, pasi ne date 11.11.2019 (pas vleresimit te ofertave), u ka ardhur nje shkrese ne AQSCert ku konstaton se ka patur lapsus sistemi dhe se tashme certifikatat jane te vlefshme online. Ne permbajtje te ketyre certifikatave te leshuara nga AQSCert eshte bere sqarimi se per te kerkuar lidhur me vlefshmerine e tyre mund hyjne ne faqen zyrtare [www.aqscert.org](http://www.aqscert.org). Dhe nga verifikimi i kryer rezultonte qe daten e vleresimit nga KVO-ja ISO-t te ishin te pezulluara, pra io te vlefshme. Ne shqyrtimin e ankeses se Operatorit Ekonomik "DELTA DONI" Sh.p.k, duhej te ishte mbajtur i njejti qendrim, pasi vendimet nuk mund te ndryshojne ne varesi te sistemeve elektronike. Ishte pergjegjesi e organit certifikues dhe operatorit ekonomik pjesmarres qe te merrnin masat perpara konkurrimit ne proceduren e prokurimit dhe te benin aktive, te vlefshme certifikatat ISO.

(4) Ne dokumentat e tenderit, Shtojca 9 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", ne piken 2.3.4, eshte kerkuar: Operatori Ekonomik duhet te kete mjet transporti ATV frigoriferik, ne pronesi ose ne perdorim sipas kontrates noteriale, te vertetuar me: leje qarkullimi, siguracion, taksat e mjetit, leje e transportit qe leshohet nga Bashkia, kontroll i mjetit, leje higjeno-sanitare, certificate pronesie.

Ne permbushje te kriterit te mesiperm OE, dokumentacioni i mjetit te dorezuar nuk ka kapacitet te mjaftueshern transportues sic kerkohet ne kriteret e vecanta si dhe certificate per leje transporti duhet te nxirret nga Bashkia ne territorin e se ciles eshte regjistruar mjeti.

(5) Ne dokumentat e tenderit, Shtojca 9 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit", ne piken 2.3.7, eshte kerkuar: Operatori Ekonomik duhet te kete "Njesi Prodhimi Bulmeti", ne pronesi ose ne perdorim sipas kontrates noteriale memarveslyebashkepunimi/furnizimi sipas kontrates noteriale ...

Ne permbushje te kriterit te mesiperm OE, ka dorezuar ne Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacion me mangesi, pasi "pretendohet se" Kartela e Pasurise se Paluajtshme me status DEPO te sherbeje edhe per fabrike qumeshiti, edhe per magazine frigoriferike, edhe per magazine ushqimore dhe ambiente ndihmese. Leja higjieno-sanitare ka mosperputhje ne daten e leshimit me daten e marrjes ne perdorim te objektit nga ana e ketij subjekti.

Referuar kriterëve te vecanta te kualifikimit stricto sensu autoriteti kontraktor ka parashikuar detyrimin e disponueshmerise (pronesi ose ne perdorim ose me marveshje bashkepunimi/furnizimi sipas kontrates noteriale) se nje njesie prodhimi bulmeti. Gjykojme se me ane te dokumentacionit te dorezuar ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike, operatori ekonomik "DELTA DONI" shpk nuk ka permbushur kriteret e vecanta te kualifikimit ne drejtim te vertetimit te disponueshmerise se niesise se prodhimit te bulmetit.

Nje nder parimet kryesore te zhvillimit te procedures se prokurimit eshte ai barazise ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", te ndryshuar. Me marrjen pjese ne proceduren e prokurimit, operatorët ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme.

(6) Ne dokumentat e tenderit, Shtojca 9 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, ne piken 2.3.3, eshte kerkuar: Operatori Ekonomik duhet te kete nje numer mesatar prej 5 punonjesish ne muaj per vitin 2019, vertetuar me listepagesen e deklaruar permes formes elektronike, ku te specifikohet numri i punonjesve per cdo muaj.

Listpagesa e muajit shtator e dorezuar nga operatori ekonomik nuk eshte deklaruar permes formes se kerkuar per kete kriter (nuk eshte deklaruar elektronikisht).

(7) Ne dokumentat e tenderit, Shtojca 9 "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, ne piken 2.3.10, eshte kerkuar qe operatori ekonomik te paraqese mostrat per secilin nga artikujt e lotit, te shoqeruar me deshmi te rezultateve dhe testimeve zyrtare.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur mostrat me deshmi te rezultateve qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike te kerkuara. Pavaresisht mungeses se flete-analizave me te gjithë parametrat e kerkuar, Komisioni i ngritur per verifikimin dhe marrjen ne dorezim te mostrave per paraqitura ne proeduren e prokurimit kane kualifikuar kete operator.

Ne interpretim te kriterëve te kualifikimit te percaktuara nga autoriteti kontraktor e njeherazi ne respekt te nenit 46 pika 1 germa "a" dhe "b" te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin

publik", i ndryshuar, ne te cilin parashikohet se: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedural e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: cdo operatori ekonomik i kerkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, te leshuara nga autoritetet kompetente shteterore, per veprimtarite e kerkuara dhe per te cilat do te lidhet kontrata; b) aftesia teknike: operatoret ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten.

Operatori Ekonomik "DELTA DONI" ne mungese te dokumentacionit te kerkuar shprehimisht ne dokumentat e tenderit eshte ne kushtet e mospermbushjes se kriterave kualifikuese dhe mbeshtetur ne keto fakte kerkojme skualifikimin e tij.

Kemi besimin se Ju, si Komision i Shqyrtimit i Ankesave dote merrni parasysh arsyet e ngritura me siper, per te siguruar zbatim te drejte te ligjit dhe trajtim te barabarte e jo diskriminues te Operatoreve ekonomike ofertues dhe kerkojme nga ana Juaj:

1. Pranimin e ankeses se Operatorit Ekonomik "AGS" Sh.p.k,
2. Skualifikimin nga kjo procedure prokurimi te shoqerise: "DELTA DONI" Sh.p.k;

II.7. Me shkresën nr. 2270/4 prot., datë 19.11.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes duke mos e pranuar ankesën. Konkretisht, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes së ankesës argumenton se:

[...]

Ne lidhje me pretendimet e mesiperme arsyetojme se: Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme (referuar nenit 46, pika 1, te ligjit nr. 9643, date. 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar). Gjithashtu Neni 55 i Ligjit 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikon: I. "Ofertafituese duhet te jete: a) oferta qe ne baze te kerkesave dhe kriterave te percaktuara ne dokumentat e tenderit, ploteson kerkesat e objektit te prokurimit me cmimin me te ulet. 2. Autoriteti Kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme, per te percaktuar, oferten fituese, ne perputhje me procedurat dhe kriteret e percaktuara ne dokumentat e tenderit. Nuk duhet te perdoret asnje kriter se nuk eshte perfshire ne dokumentat e tenderit. 3. Vleresimi i ofertave behet vetem ne baza teknike dhe ekonomike. 5. Autoriteti Kontraktor percakton oferten me te mire, pas krahasimit dhe vleresimit te ofertave".

Per sa me siper, Ju sqarojme se, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, ka shqyrtuar dhe vleresuar cdo oferte te paraqitur ne SPE, referuar pajtueshmerise se tyre me cdo kriter kualifikimi, te parashikuar ne dokumentat standarte te tenderit, dhe pas klasifikimit, renditja e tyre ne SPE, eshte bere ne baze te cmimit te ofertes. Ne lidhje me procesin e vleresimit, sistemi ka administruar automatikisht te dhenat e vleresimit dhe komentet mbi to, duke njoftuar ne rruge elektronike ofertuesit.

-Persa i perket pretendimit se: "Referuar Ekstraktit te Regjistrimit Tregtar te OE "DELTA DONI!" rezulton qe kuotat e kapitalit te zoterohen nga dy ortak: 50% nga Ortaku Ferdi Gjata

(njekohesisht edhe administrator) dhe 50% nga Ortaku Edmond Gjata. Plotesimi i kesaj shtojce nuk eshte here konform kerkesave te ligjit "Per Prokurimin Publik", pasi nuk eshte plotesuar edhe per te dy ortaket e shoqerise ", ju sqarojme se, pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur ne sistem nga OE, referuar kriterit te pergjithshern te kualifikimit (vetedeklarata me shkrim e subjektit sipas shtojces nr.8), eshte konstatuar se OE "DELTA DONI" sh.p.k, e permbush kete kriter.

Ne nenin 15 te VKM nr. 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet: "Permbushja e kriterëve te pergjithshme te kualifikimit/pjesmarrjes, sipas parashikimeve te nenit 45 te LPP realizohet nepermjet paraqitjes se nje vetdeklarate me shkrim nga ana e kandidatit ose ofertuesit. Vetdeklarimi behet nen pergjegjesine e plote te kandidatit ose ofertuesit".

Ne njoftimin e perbashket te Agjensise se Prokurimit Publik me nr. 1155 Prot. date 01.02.2019 dhe Ministrise se Drejtesise nr. 1001/1 Prot. date 01.02.2019, parashikohet qe: "Ne fazen e vleresimit te ofertave, autoriteti kontraktor do te beje, ne cdo rast verifikimet per personat e deklaruar nga operatori ekonomik ne kete Shtojce .... Personi pergjegjes do te hyje ne regjistrin elektronik te gjendjes gjyqesore per te siguruar informacion mbi gjendjen gjyqesore te individëve te deklaruar nga operatori ekonomik ofertues ". Per sa me siper, nga ana e Autoritetit Kontraktor QEZHEF, jane kryer verifikimet perkatese sipas detyrimeve ligjore parashikuar ne kete njoftim.

-Persa i perket pretendimit se: "OE nuk ka dorezuar ne sistemin SPE dokumentacionin (vertetim debie) ne origjinal ose te noterizuar, dokumenti i dorezuar nga ana e Oli-se eshte i pasakte pasi ne DST e publikuar nga AK ne shtojcen 9 te saj eshte kerkuar qe Te gjithë dokumentat duhet te jene origjinal ose kopje te noterizuara te tyre ... ", ju sqarojme se, pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur ne sistem nga OE, referuar kriterit te vecante pika 1 germa e, eshte konstatuar se, OE "DELTA DONI" sh.p.k e permbush kete kriter. Dokumenti permban elementet e vlefshmerise se nje shkrese.

-Persa i perket pretendimit se: "Nga verifikimi prane OSHEE rezulton se OE eshte titullar dhe perdorues per disa kontrata ne qytetin e Beratit, per te cilin nuk ka dorezuar vertetim te shlyerjes se taksave vendore per vitet 2017, 2018, 2019 sipas pikes 2.1.1 te shtojces 9 te DST", ju sqarojme se, pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur ne sistem nga OE, referuar kriterit te vecante pika 2.1.1, eshte konstatuar se, OE "DELTA DONI" sh.p.k, e permbush kete kriter. Referuar Ekstraktit te Regjistrit Tregtar, ky OE nuk ushtron aktivitet ne Berat.

- Persa i perket pretendimit se: "Eshte e papranueshme qe KVO te ndryshoje qendrimin dhe vendimin e saj pasi ne daten 11.11.2019 (pas vleresimit te ofertave) u ka ardhur nje shkrese ne AQSCert ku konsiston se ka patur lapsus sistemi dhe se tashme certifikatat Jane te vlefshme online ... Ne shqyrtimin e ankeses se OE "DELTA DONI" sh.p.k, duhej te ishte mbajtur i njeiti qendrim, pasi vendimet nuk mund te ndryshojne ne varesi te sistemeve elektronike. Ishte pergjegjesi e organit certifikues dhe OE pjesemarrës qe te marrin masa perpara konkurimit ne proceduren e prokurimit dhe te benin aktive, te vlefshme certifikatat ISO", ju sqarojme se, pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur bashkelidhur ankeses se OE "DELTA DONI" sh.p.k, si dhe verifikimit elektronik te tij nga KVO, referuar kriterit te vecante pika 2.3.2, eshte pranuar ankesa e tij dhe eshte konstatuar se OE "DELTA DONI" sh.p.k, e permbush kete kriter.

-Persa i perket pretendimit se: "Dokumentacioni i mjetit te dorezuar nuk ka kapacitet te mjaftueshem transportues sic kerkohet ne kriteret e vecanta si dhe certifikata per leje transporti

*duhet te nxirren nga Bashkia ne territorin e se ciles eshte regjistruar mjeti", ju sqarojme se, pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur ne sistem nga OE, referuar kriterit te vecante pika 2.3.5, eshte konstatuar se, OE "DELTA DONI" sh.p.k, e permbush kete kriter sipas parashikimeve te tij ne DST.*

*-Persa i perket pretendimit se: "OE ka dorezuar ne SPE dokumentacion me mangesi pasi "pretendohet se" Kartela e Pasurise se Paluajtshme me status Depo te sherbeje edhe per fabrike qumeshti edhe per magazine frigoriferike, edhe per magazine ushqimore dhe ambiente ndihmese. Leja higjeno-sanitare ka mosperputhje ne daten e leshimit me daten e marrjes ne perdorim te objektit nga ana e ketij subjekti ", ju sqarojme se, pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur ne sistem nga OE, referuar kriterit te vecante pika 2.3.7, eshte konstatuar se, OE "DELTA DONI" sh.p.k, e permbush kete kriter, pasi statusi i pasurise se paluajtshrne pasqyruar ne kartelet, nuk eshte "Depo". Gjithashtu persa i perket pretendimit per "mosperputhje midis dates se leshimit te lejes higjeno-sanitare me daten e marrjes ne perdorim te objektit", sqarojme se, leja higjeno-sanitare leshohet per objektin e zhvillimit te aktivitetit, e cila eshte pa afat dhe nuk ka lidhje me perdoruesin e objektit, sipas kontrates se huaperdorjes. Pra subjektet, qe e marrin ne perdorim objektin, mund te jene te ndryshem ne periudha kohore te ndryshrne.*

*-Persa i perket pretendimit se: "Listepagesa e muajt shtator e dorezuar nga OE nuk eshte deklaruar permes formes se kerkuar per kete kriter (nuk eshte deklaruar elektronikisht) ", ju sqarojme se, pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur ne sistem nga OE, referuar kriterit te vecante pika 2.3.3, eshte konstatuar se OE "DELTA DONI" sh.p.k, e permbush kete kriter.*

*-Persa i perket pretendimit se: "OE nuk ka paraqitur mostrat me deshmi te rezultateve qe vertetojne pajtueshmerine e produkteve me specifikimet teknike te kerkuara. Pavarsisht mungeses se flete-analizave me te gjitha parametrat e kerkuar, komisioni i ngritur per verifikimin dhe marrjen ne dorezim te mostrave te paraqitura ne proceduren e prokurimit kane kualifikuar kete operator, ju sqarojme se, pas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur ne sistem nga OE, referuar kriterit te vecante pika 2.3.10, eshte konstatuar se OE "DELTA DONI" sh.p.k e permbush kete kriter.*

*Perfundimisht, persa i perket pretendimeve mbi: "OE "DELTA DONI"sh.p.k, ne mungese te dokumentacionit te kerkuar shprehimisht ne dokumentat e tenderit eshte ne kushtet e mospermbushjes se kriterave kualifikuese dhe mbeshtetur ne keto fakte kerkojme skualifikimin e tij ". Sqarojme se, ne piken 5/a dhe 5/c te Nenit 53, te Ligjit 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet: "Autoriteti Kontraktor nuke pranon nje oferte: a) kur ofertuesi nuk eshte i kualifikuar; c) kur oferta e tij nuk perputhet me specifikimet e percaktuara ne dokumentat e tenderit". Per sa me siper, ne rastin konkret, ofertat qe jane vleresuar te vlefshme, jane ne perputhje me kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne DST dhe nuk perbejne shkak per skualifikim. Vleresimi, kualifikimi dhe vendimmarrja, per nje procedure prokurimi, nuk mund ti referohet pretendimeve, por verifikimit dhe analizimit, te pajtueshmerise se ofertave te paraqitura nga Operoret Ekonomik, me specifikimet dhe kriteret e kualifikimit.*

*Referuar Nenit 63, pika 1 e ligjit 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, parashikohet qartesisht: "Cdo person qe ka ose ka patur interes ne nje procedure prokurimi dhe kur eshte demtuar apo rrezikohet te demtohet nga nje vendim i Autoritetit Kontraktor, i marre ne kundërshtim me kete ligj mund ta kundërshtojë vendimin ". Per sa me siper, neni 63 pika 1, kerkon shprehimisht, qe ankuesi, jo vetem te kete interes, por edhe te jete demtuar realisht, apo te*



rrezikohet te demtohet nga vendimi, qe ka marre Autoriteti Kontraktor. Ne rastin konkret Operatori Ekonomik, nuk rrezikon te demtohet nga Vendimi i Autoritetit Kontraktor, objekt ankimi. Nje ankimues, dote konsiderohet i demtuar, kur ai ka vuajtur apo rrezikon dukshem te vuaje, nje pasoje te ardhur drejtperdrejt nga veprimi i Autoritetit Kontraktor, dhe kjo mund te rregullohet permes ankimit. Ne rastin konkret, pasoja nuk ka ardhur nga veprimet e drejtperdrejta te Autoritetit Kontraktor, por nga vete Operatori Ekonomik ankimues (vlera e ofertes se tij).

Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur asnje prove per vertetimin e pretendimeve te tij, nderkohe qe, dokumentacioni i paraqitur ne SPE dhe mostrap e dorezuara, ditet e zhvillimit te tenderit, jane te depozituara prane Autoritetit Kontraktor, duke krijuar mundesine per kryerjen e verifikimeve, nga ana e cdo autoriteti kompetent, ne cdo kohe.

Ne nenin 46 pika 1 te ligjit "Per Prokurimin Publik" Nr. 9643, date 20.11.2006, i ndryshuar, parashikohet "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese". Per sa me siper, OE "DELTA DONI" sh.p.k, eshte kualifikuar pasi ka permbushur te gjitha kriteret e kualifikimit, te kerkuara nga AK ne Dokumentat e Tenderit. Ne vijim te konstatimeve te sipercituara, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qendron. Ne mbeshtetje te nenit 63, te Ligjit Nr.9643, dt.20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", te ndryshuar dhe nenit 78, pika 6, germa c, te VKM Nr.914 dt.29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik" e ndryshuar, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, me unanimitet: **VENDOSI:** Te mos pranoj ankesen e paraqitur nga operatorit ekonomik "AGS" sh.p.k, ne proceduren e prokurimit "Procedure e Hapur" "Marreveshje Kuader me afat 12 mujor", me objekt "Blerje ushqime per vitin 2020", ndare ne 5 lote, konkretisht per Lotin II "Blerje bulmet qumesht kos djath gjize", me fond limit 54 830 853 lek pa tvsh, te zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor **QEZHEF.**

II.8. Në datën 27.11.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.9. Në datën 16.12.2019, nëpërmjet shkresës me nr.2270/7 prot., datë 11.12.2019, me objekt: "Dërgim informacioni mbi ankesën e operatorit ekonomik "A G S" sh.p.k., në lidhje me procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur" "Marrëveshje kuadër me afat 12 mujor", me objekt "Blerje ushqimesh ndarë në 5 lote", Loti II "Blerje bulmet, qumësht, kos, djathë, gjizë", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues "A G S" sh.p.k.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

## Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik "A G S" sh.p.k. me arsyetimin se "Ne dokumentat e tenderit, Shtojca 9 "Kriteret e Përgjithshme tepranimit/kualifikimit", është kërkuar që: ... Keto kritere duhet të plotësohen me dorezimin e vetedeklarates me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertes, sipas Shtojcës 8. Referuar përmbajtjes së shtojcës 8... "Operatori Ekonomik duhet të vetedeklarojë për ... Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyresit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik. Referuar Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar të Operatorit Ekonomik "DELTA DONI" rezultojnë kuotat e kapitalit të zotërohen nga 2 ortakë: 50 % nga Ortaku Ferdi Gjata (njekohesisht edhe Administrator) dhe 50 % nga Ortaku Edmond Gjata. Plotësimi i kësaj shtojce nuk është bërë konform kërkesave të Ligjit për Prokurimin Publik, pasi nuk është plotësuar edhe për të dy Ortaket e Shoqërisë", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 "Kriteret e përgjithshme të kualifikimit", të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

### DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënues për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyresit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_ etj.

*nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.*

- *Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*

- *Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).*

- *Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

*Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.*

*Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_*

*Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_*

*Vula \_\_\_\_\_*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Delta Doni” sh.p.k., për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;*

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, operatori ekonomik “Delta Doni” sh.p.k. ka dorëzuar Shtojcën 8 “Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme”, nga ku rezulton se nuk ka deklaruar në formën dhe mënyrën e duhur emrat e të gjithë ortakëve të shoqërisë sipas shtojcës 8 të dokumentave standarte të tenderit, e rrjedhimisht edhe të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Nga shqyrtimi i Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar të subjektit “Delta Doni” sh.p.k., në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit, në pikën 12 dhe 13 të këtij ekstrakti, citohen emrat e dy ortakëve

të kësaj shoqërie, konkretisht z.F.GJ dhe Z.E.GJ. Ndërkohë, që shtojca 8 ”Deklarata mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme”, e paraqitur në këtë procedurë prokurimi, është plotësuar vetëm në emër të njërit prej ortakëve, z.F.GJ. Pra, operatori ekonomik ”Delta Doni” sh.p.k. nuk ka plotësuar shtojcën 8 sipas formatit standart të saj, i cili kërkon domosdoshmërisht citimin në mënyrë nominale të emrit të cilido *anëtari të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut*, të operatorit ekonomik të cilët nuk duhet të jenë ose të kenë qënë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.

KPP gjykon se shtojca “Deklaratë për përmbushjen e kritereve të përgjithshme” nuk lë vend për konfuzion për mënyrën e plotësimit të saj dhe akoma më tej, këto shtojca janë standarte dhe duhet të plotësohen me përpikmëri në mënyrën që janë konceptuar, për më tepër që janë vetëdeklarime të vetë operatorëve ekonomikë dhe rrjedhimisht janë lehtësisht të plotësueshme nga ana e tyre.

III.1.5. Gjithashtu, referuar Seksionit II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, pika 1.1. të dokumentave të tenderit ku është përcaktuar: *“Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Delta Doni” sh.p.k. nuk është i saktë dhe në përputhje me dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik “A G S” sh.p.k., mbi kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Delta Doni” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, referuar arsyetimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Delta Doni” sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit. Rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Delta Doni” sh.p.k. nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të pranohet ankesën e operatorit ekonomik “A G S” sh.p.k. për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur”*, me nr. REF-36194-09-17-2019, me objekt Loti 2 *“Blerje bulmet, qumësht, kos, djathë, gjizë”*, me fond limit 54.830.853 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.10.2019, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Delta Doni” sh.p.k., dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “A G S” sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.1816 Protokolli**

**Datë 27.11.2019**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Enkeleda Bega</b>	<b>Vilma Zhupaj</b>	<b>Lindita Skeja</b>	<b>Merita Zeqaj</b>

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**